

**DEPARTEMENT
GESUNDHEIT UND SOZIALES**

Abteilung Gesundheit

Shërbimi mjekësor i kantonit

29 Tetor 2021

INFORMACION PËR PRINDËRIT

Sjellja me rastet e Covid-19 në shkollën fillore të Aargau në dimër 2021/22

Arsimi i mirë shkollor ashtu si edhe mbrojtja e shëndetit janë të rëndësishme. Zbatimi i përpiktë i masave të higjienës dhe mbrojtjes si dhe proceset dhe rregullat e qarta për rastin kur në shkollë sëmuren nxënës dhe nxënës ose personeli mësimor me Covid-19, kontribuojnë në faktin që të dyja pretendimet të zbatohen siç duhet.

Prandaj ju lutemi që të mbani parasysh pikat e mëposhtme, të cilat vlejné në shkollën fillore të Aargau duke filluar nga 1 Nëntori 2021:

- Parimisht vlen gjithmonë dhe për të gjitha nxënëset dhe nxënësit si dhe për personelin arsimor: Kush ka simptoma të sëmundjes, nuk shkon në shkollë dhe testohet. Testet Covid për personat nën 16 vjeç janë falas.
- Nxënëset dhe nxënësit si dhe personeli mësimor me një rezultat pozitiv të testet shkojnë menjëherë në izolim dhe ja raportojnë këtë gjë menjëherë shkollës. Contact Tracing Center (CONTI) e kantonit merre kontakt me personin në fjalë.
- Nëse në klasë shfaqen tre ose më shumë raste të konfirmuara brenda një jave, shërbimi mjekësor i kantonit urdhëron një test të detyrueshëm të pështymës për të gjithë nxënëset dhe nxënësit të asaj klase. Marrja e mostrave kryhet në shkollë. Kush nuk është prezent, e organizon vetë testin dhe ja raporton rezultatin e testit shkollës.
- Klasat që preken nga dy ose më shumë raste të konfirmuara janë të detyruar që gjatë 10 ditëve të heqin dorë nga të kënduarit në grup në klasë si dhe nga llojet e sportit me kontakt. Për klasat e prekur nga klasa e 5-të fillore përveç të tjerave urdhërohet një detyrim dhjetë ditor për mbajtjen e maskës në hapësirat e brendshme të shkollës. Klasat deri në klasën e 4-të fillore heqin dorë nga mësimi që përfshin të gjithë klasën (Përrjashtim: departamentet me disa klasa). Nëse nga testi i të gjithë klasës nuk rezultojnë raste të tjera pozitive, këto masa të menjëhershme revokohen.
- Për të gjithë personat, urdhrat e shërbimit mjekësor të kantonit ose të CONTI janë të detyrueshëm për tu zbatuar.

Të gjitha pikat e përmendura kanë si qëllim, që të reduktojnë domosdoshmërinë e karantinave (të klasave) dhe ta vazhdojnë mundësisht pa telashe procesin mësimor. Në të njëjtën kohë duhet që rreziku i infektiveve dhe i përhapjes së mëtejshme të virusit Covid-19 të mbahet i ulët.

Të gjitha shkollat vazhdojnë të kenë mundësinë, që të marrin pjesë në testimin e përsëritur. Pjesëmarrja e mundësisht të gjithë nxënësve dhe nxënësve këshillohet me forcë. Ju lutemi mbështeteni këtë masë të thjeshtë por të rëndësishme, për të penguar mundësisht përhapjen e mëtejshme të virusit Covid-19 në mjedisin shkollor.

Informacione të detajuara gjeni online në www.ag.ch/coronavirus-schulen.

Autoritetet shëndetësore dhe shkollat ju falënderojnë nëse nda ndihmoni që ti arrijmë këto objektiva.
Shumë faleminderit!